

Journalism students Access to Public Relations in Albania

*Jonila Godole**

Abstract

This paper aims to introduce the approach of journalism students to PR-practices and public relations in general. The paper is based on empirical results obtained from an extensive survey with students of journalism in Tirana, Elbasan and Shkodra in 2015. The main goal is to analyse the priorities of students before emerging in the labour market and specifically their attitude to PR as field employment in the future. At a time when the boundaries between PR and classical journalism are becoming indecipherable, we are interested to know the attitude of the students of journalism to these developments. How endangered is the journalistic profession from interference of PR offices? How optimistic are they about the future of journalism? Where do they see themselves employed in the near future? Etc. The paper will attempt to answer these questions and others that will raise with concrete figures.

Keywords: *Journalism education, PR, social status of journalists, socializing in the newsroom*

*Dr. JonilaGodole, Department of Journalism and Communication, University of Tirana. Email: jonila_godole@yahoo.de

Qasja e studentëve të gazetarisë ndaj Marrëdhënieve Publike në Shqipëri¹

Abstrakt

Ky punim synon të prezantojë qasjen e studentëve të gazetarisë ndaj praktikave të PR dhe marrëdhëniet me publikun në përgjithësi. Punimi bazohet në rezultatet empirike të përfutuara nga një anketë e gjerë me studentë gazetarie në Tiranë, Elbasan dhe Shkodër gjatë vitit 2015. Synimi kryesor është të analizohen prioritetet e studentëve përpara se të dalin në tregun e punës dhe specifikisht qëndrimi i tyre ndaj PR si fushë punësimi në të ardhmen. Në kohën kur kufijtë mes PR dhe gazetarisë klasike sa vjen dhe po bëhen më të padeshifrueshëm, na intereson të njohim qëndrimin e studentëve të gazetarisë ndaj këtyre zhvillimeve. Sa të rrezikuar e shohin ata profesionin e gazetarit nga ndërhyrjet e zyrave të PR-it? Sa optimistë janë ata për të ardhmen e gazetarisë? Ku e shohin veten të punësuar në të ardhmen e afërt? Etj. Punimi do të përpiqet t'u japë përgjigje me shifra konkrete këtyre pyetjeve dhe të tjerave që do ngre.

Fjalë kyç: *Edukim universitar në gazetaresi, PR, status social i gazetarëve, socializim*

¹ Referim i mbajtur në konferencën shkencore “Advertoriali: Media mes informacionit masiv dhe marrëdhënieve me publikun”, 19.12.2016. Autorja falenderon koleget Dr. Nirvana Shkëlzeni (Elbasan) dhe Dr. Ardita Hysa (Shkodër) për ndihmesën e tyre në realizimin e anketave.

Hyrje

Marrëdhënia e edukimit akademik të gazetarëve me profesionin e mëvonshëm është trajtuar shpesh si konfliktuale. Konflikti qëndron kryesisht në diskrepancën mes teorisë që ofron edukimi në universitet dhe njohurive praktike që ofron dhe kërkon profesioni. Sipas studiuësve perëndimorë, pjesa më e madhe e gazetarëve hyjnë në profesion më shumë përmes trajnimeve profesionale se sa përmes edukimit akademik². Kurse në Shqipëri studimet e viteve të fundit kanë treguar se mbi 60% e gazetarëve që punojnë në media diplomohen për gazetari ose shkencë komunikimi³. Studimet shërbejnë kështu si pjesë e socializimit në profesion. Pedagogët me një background profesional mendohet t'u transmetojnë studentëve dijet praktike dhe aftësitë të bërit gazetari në redaksi⁴. Në rastin më të mirë, socializimi i tyre duhet të thellohet përmes periudhave të praktikës në redaksi dhe me kthimin në auditor pritet që ata të sjellin njohuritë dhe vlerat profesionale të përfutuara në vendin e punës⁵. Në rastin e Shqipërisë, nga teoria në praktikën e gazetarisë ka një diferencë të madhe, e cila vazhdimisht është tematizuar nga studentët pas mbarimit të studimeve për gazetari. Po a shërben kjo si një arsye e mjaftueshme që ata të

²Mark Deuze, „Global journalism education. A conceptual approach“. *Journalism Studies* 7:1; 2006.

³Jonila Godole. *Gazetaria shqiptare në tranzicion*, Papirus, Tiranë, 2014.

⁴Donica Mensing, Realigning Journalism Education. In Bob Franklin & Donica Mensing (eds.) *Journalism Education, Training and Employment*. Neë York and London: Routledge, 2011.

⁵Weaver, David H., & Willnat, Lars (eds.) *The Global Journalist in the 21st Century*. New York and London: Routledge, 2012.

heqin dorë nga gazetaria, dhe t'i përkushtohen profesioneve të tjera?

Metodologjia dhe të dhëna demografike

Ky punim synon të prezantojë kryesisht qasjen e studentëve të gazetarisë ndaj praktikave të PR dhe marrëdhieve me publikun në përgjithësi. Punimi bazohet në rezultatet empirike të përfuara nga një anketë e gjerë me studentë në departamentet e gazetarisë nga universitetet publike në Tiranë (41,2%), Elbasan (37,4%) dhe Shkodër (21,4%) gjatë vitit 2015⁶. Anketa u plotësua nga 465 studentë, prej të cilëve 71,8% ishin studente femra dhe 28,2% studentë meshkuj. Moshja e tyre mesatare varion nga 18 vjeç në 35 vjeç. Ata u zgjodhën nga të gjitha nivelet e edukimit që ofrojnë këto departamente, konkretisht 84,5% e tyre ndiqnin Bachelorin në gazetari dhe 15.5% studionin për master. Institucione të tjera nuk u morën në konsideratë për shkak të numrit të vogël të studentëve.

Anketa u shpërnda dhe u plotësua në auditore në prezencë të stafit organizues të studimit. Kjo anketë është pjesë e studimit ndërkombëtar "Journalistic students around the globe"⁷, në të cilin marrin pjesë mbi 44 vende të botës. Studentët u pyetën për pritshmëritë e tyre nga tregu i punës, për vlerësimin e idealeve normative të gazetarisë, por edhe për vlerësimin e studimeve të tyre universitare. Për këtë punim ne do të fokusohemi vetëm të qëndrimi i tyre ndaj PR si fushë punësimi në të ardhmen, në një

⁶ Rezultate më të zgjeruara të anketës mund të gjenden në studimin „Journalism education in Albania“ botuar online në faqen e Institutit për Demokraci, Media dhe Kulturë (IDMC). <https://drive.google.com/file/d/0B8L2HNXvoFmsWIBIQXFWOUFoc2s/view>

⁷ <http://www.jstudentsproject.org/p/network.html>

kohë kur kufijtë mes PR-it dhe gazetarisë klasike sa vjen dhe bëhen më të padukshëm. Gjithashtu punimi ngre një sërë pyetjesh të tjera, si për shembull: sa të rrezikuar e shohin ata profesionin e gazetarit nga ndërhyrjet e zyrave të shtypit dhe marrëdhënieve me publikun? Sa optimistë janë ata për të ardhmen e gazetarisë? Ku e shohin veten të punësuar në të ardhmen e afërt? Punimi do të përpiqet t'u japë përgjigje me shifra konkrete këtyre dhe pyetjeve të tjera që ngre.


Rezultatet

Perspektivat profesionale

Pritshmëritë profesionale të studentëve janë të rëndësishme për të kuptuar si e shohin ata të ardhmen e tyre. Nga njëra anë studentët reflektojnë cilësinë e edukimit të tyre universitar dhe të tregut, nëse zgjedhin të vazhdojnë të punojnë ose jo në fushën e gazetarisë. Nga ana tjetër, duke zgjedhur një profesion tjetër pas studimeve nënkupton se studentët arrijnë dikur t'i njohin më mirë interesat e tyre, gjë që ndikohet nga shumë faktorë, si situata në tregun e punës, pagat etj. Megjithë pakënaqësitë që studentët mund të kenë për kohën në auditor, sidomos sepse nuk u ofrohet praktikë në media gjatë studimeve, 63% e tyre shprehen se dëshirojnë të vazhdojnë në fushën e gazetarisë në të ardhmen, ndërsa 20% e tyre duan të punojnë në fushën e Marrëdhënieve Publike (PR) ose të komunikimit në korporata. Interesant është fakti që 10% dëshirojnë të vazhdojnë në fushën e mësimdhënies, që nënkupton studimet doktorale dhe mbase punësim si pedagog ose staf akademik. Edhe pse pagat e pedagogëve në universitetet shqiptare nuk janë të larta, një kontratë e përhershme në mësimdhënie konsiderohet një punë e sigurt.

Grafiku 1: Perspektivat profesionale të studentëve

- Journalism
- Public Relations/Corporate Communications
- Advertising
- Teaching and Research



Ndërkohë nga ata që zgjedhin të vazhdojnë punën në media, 48% preferojnë një karrierë në televizion (Grafiku 2). Edhe studime të tjera të fushës kanë treguar se profesioni i synuar është kryesisht moderator ose folës lajmesh⁸. Perceptimi në Shqipëri i publikut, por edhe i studentëve të gazetarisë është se moderatorët paguhen shumë më mirë se reporterët. Nga ana tjetër, moderimi në televizion është faktor i rëndësishëm për rritjen e popullaritetit. Radio vlerësohet si vend i mundshëm pune vetëm nga 7% e të pyeturve edhe pse shumë nga moderatorët televizivë të suksesshëm sot, e kanë nisur aty karrierën e tyre.

⁸Godole, Jonila (2014). Gazetaria shqiptare në tranzicion. Papirus

Grafiku 2: Fushat e punësimit të preferuara




Rezultatet tregojnë se 9% e të pyeturve dëshirojnë punën në shtypin e shkruar, kurse 8 përqind e tyre në marrëdhëniet publike brenda redaksisë, pasuar nga preferencat për median online, kryesisht agjensitë online të lajmeve (6%).

Praktika gjatë studimeve

Të pyetur për mundësitë e tyre të praktikave gjatë studimeve (Grafiku 3), 25% e studentëve u shpreh se ka punuar në televizion, 21% në gazetë, 20% në radio dhe 18% në mediat online. Mundësitë më të pakta kanë qenë në fushën e reklamave dhe të PR-it vetëm 3% në secilën prej tyre edhe pse studentët janë shprehur se kanë pasur dëshirë të punonin aty. Akoma më të vogla janë shanset për studentët e gazetarisë të kenë akses në zyrat e shtypit të qeverisë apo ministrive.

Grafiku 3: Përvojat në praktika dhe organizim (%)



Interesant është fakti që studentët më “investigativë” janë ata që kanë pasur përvojë pune gjatë studimeve ose motivim nga familja. Ata i gjen në shtypin e shkruar, në rubrika më tradicionale ose kronika televizive të lajmeve “hard news”, në fushën e politikës, konflikteve ndërkombëtare etj. Ndërsa studentët që preferojnë TV, produksion filmi ose PR, nuk dallojnë shumë nga të parët, megjithatë në një farë mënyre ata kanë interes më të fortë për përmbajtje gazetareske të tipit lifestyle, kulturën dhe argëtimin.


Sfidat kryesore të gazetarisë

Përmes gjithë problemeve (Grafiku 5), studentët rankojnë si një ndër rreziqet më kryesore të gazetarisë, sulmet fizike ndaj gazetarëve (81,2%) dhe përplasjet mes medias dhe politikës (81,1%), pasuar nga etika e dobët profesionale (77%) dhe ndërhyrjet e shtetit në media (72.4%).

Rreziqe të tjera që i kanosen medias cilësore konsiderohen partishmëria e gazetarëve (63.3%) dhe kërkesat në rritje të pronarëve për përfitime (61.7%), censura (59.3%) dhe përgatitja jo e duhur profesionale e studentëve (58%). Pakënaqësia për përgatitjen e tyre duket edhe në vlerësimin që i japin cilësisë, edukimit në universitet, ku 48.2% e të pyeturve shprehen se kjo mbetet edhe një sfidë e shkollës së gazetarisë. Me fjalë të tjera, që shkolla të ofrojë më shumë cilësi në mësimdhënie dhe praktikën e gazetarisë. Problematike gjithashtu konsiderohen, vetëcensura (47.7%) dhe përqëndrimi i pronësisë (45.8%) etj.

Nga përgjigjet e studentëve kundrejt pyetjes *„A përbën problem për një gazetar të punojë gjithashtu në PR dhe menaxhim të informacionit?“* krijohet përshtypja se qasja ndaj PR dhe gazetarisë në përgjithësi NUK është shumë e ndryshme. Sidomos të pyeturit në Universitetin e Tiranës kishin vështirësi në dallimin mes dy fushave, që do të thotë se një pjesë e konsiderueshme e tyre (48%) i konsideronin profesione të ngjashme.

Grafiku 5: Sfidat kryesore të gazetarisë (%)



Kjo tablo nuk u paraqit në universitetet e Shkodrës dhe Elbasanit. Një mundësi shpjegimi mund të jetë se studentët në Tiranë njihen me PR dhe marketingun që në Bachelor dhe ndoshta krijojnë përshtypjen e gabuar se këto drejtime janë pjesë integrale e profesionit të gazetarit.

Përsa i përket presionit të marrëdhënieve publike (PR) dhe lobimit nga jashtë në përgjithësi, duket se ka paqartësi nga të pyeturit, ku vetëm 33% e të cilëve e shohin këtë ndërhyrje problematike. Siç folëm më lart për paqartësinë e tyre mes PR dhe raportimit gazetaresk, ka gjasë që ata të mos e kuptojnë realisht ndërhyrjen e advertorialeve apo reklamave të fshehta në faqet editoriale të mediave (33% e studentëve nga universiteti i Elbasanit, 32% e studentëve nga Shkodra dhe 29% e studentëve nga Tirana).


Rezultatet e anketës me studentët e gazetarisë nxjerrin në pah një problem të trajtuar edhe në anketa të mëparshme, si për shembull sondazhi me gazetarët shqiptarë organizuar në vitin 2012 në kuadër të projektit ndërkombëtar World of Journalism Studies (Godole 2014) ku vetëm 15% e tyre pranoi presionin e informacioneve që vijnë nga zyrat e shtypit dhe marrëdhënieve publike, megjithë perceptimin e krijuar se ky ndikim mund të ishte më i madh se kaq.⁹Në të dyja rastet, kjo përqindje e ulët mund të ketë të bëjë me faktin që nëse pyeten direkt në lidhje me këtë çështje, gazetarët mund të kenë tendencë të minimizojnë rolin e PR-it në punën e tyre.

Statusi i gazetarit në krahasim me profesione të tjera

Studimet e viteve të fundit kanë nxjerrë në pah dobësinë e statusit të gazetarit, mungesën e kontratave të punës ose mosrespektimit të tyre në raste largimi nga puna (Godole, 2014). Këto çështje janë denoncuar në opinionin publik nga Unioni i Gazetarëve dhe nuk kanë kaluar në heshtje as për studentët e gazetarisë. Për këtë arsye shumica e studentëve e perceptojnë statusin social të gazetarëve të ngjashëm me statusin e aktorëve (55.7%), të shkrimtarëve (52.8%) dhe artistëve në përgjithësi (50.8%). Por në krahasim me mjekët (48,1%), politikanët (39.3%) apo biznesmenët statusi i tyre perceptohet si më i ulët. Studentët nuk u pyetën konkretisht se ku bazoheshin për këtë renditje, por mendohet se përveç perceptimit të përgjithshëm për një kategori punësimi të pambrojtur ligjërisht, ndikim ka edhe paga mujore dhe respekti i përgjithshëm në shoqëri.

Grafiku 4: Statusi social i gazetarit (%)

⁹https://epub.ub.uni-muenchen.de/31745/1/Country_report_Albania.pdf



Konkluzione

Ky punim synonte të ofronte disa qasje të studentëve të gazetarisë ndaj PR dhe marrëdhënieve publike në përgjithësi. Rezultatet nxjerrin në pah se studentët e shohin fushën e marrëdhënieve publike si një mundësi në të ardhmen për t'u punësuar. Nga njëra anë, aftësimi i tyre në këtë fushë u rrit shanset për të gjetur një vend pune. Nga ana tjetër, kjo flet për një tolerancë të studentëve, sidomos atyre nga Tirana dhe marrëdhënieve të medias me PR dhe fusha të tjera të menaxhimit të informacionit. A është ky një keqkuptim i studentëve për rolin e gazetarisë dhe PR-it? Apo thjeshtë një mënyrë pragmatiste për t'iu përshtatur kushteve të reja, ku artikujt reklamë (advertorials) mbushin pjesën më të madhe të mediave klasike dhe të reja? Sidoqoftë ajo që bie në sy është se gazetarët e ardhshëm që në bankat e shkollës janë të vetdijsëm për rëndësinë e PR-it, por dhe rreziqet që i vijnë gazetarisë prej tij. Roli ynë si pedagogë gazetarie është t'ua bëjmë atyre sa më të qartë, se cilët janë kufijtë

mes këtyre dy fushave dhe si t'i kuptojmë dhe aplikojmë ato në mënyrë të vetëdijshme pa harruar asnjëherë se kush është roli primar i gazetarisë në një shoqëri demokratike.

Bibliografia

Deuze, Mark. Global journalism education. A conceptual approach. *Journalism Studies* 7:1. 2006. (19-34).

Godole, Jonila. *Gazetaria shqiptare në tranzicion*. Papirus. Tiranë: 2014.

Mensing, Donica. «Realigning Journalism Education». In: Bob Franklin & Donica Mensing (eds.) *Journalism Education, Training and Employment*. Routledge. New York and London: 2011.

Weaver, David H., & Willnat, Lars (eds.). *The Global Journalist in the 21st Century*. Routledge. New York and London: 2012.